

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Nga Elton Qyno - Syri.net - Futi paisje e
ADRESA	https://www.syri.net/kronike/917104/futi-paisje-e-botox-kontrabande-285-mln-leke-te-pa-paguara-merret-i-pandehur-biznesmeni-dritan-gremi/
BURIMI	syri.net
GJENDJA	unreachable

KOHA


KAPUR NGA NE	16 shtator 2026, 13:59:13 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	16 shtator 2026, 13:38:10 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	4badd0e3d616f0b062f9ed5eb49ea17c4da4d04b08d71ff89f3d24754aded58c
TEKSTI	086aca98e6fd0b81eb974b6188ddcc39a6bd405c02181e414a918b61420956c2
PAMJA	f6861b64c8b307d5140f3a1116730ff7908ac5d494eb8d05b5fbd47315d6e9cd

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	9ab64cf1527f5558e2c08bf012caf6894a81d84d08991c91dc7b525940161c7e
E MËPARSHMJA	2c49a247871de10611c4c7a807660d32abf13316b2469e6fbb4a5d268af8d6b0
RRËNJA MERKLE	9515102868483048fab913125dfd13516db18986db3bd96a2369642ebf1c0d96
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahajo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/9ab64cf1527f5558e2c08bf012caf6894a81d84d08991c91dc7b525940161c7e>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



ÇIM PEÇA

Tradhtia që s'e panë tu ardhë



NDRIM KULLA

Gjuha si brushë dhe ironia si armë e Edi Ramës



FOTO: Anduena Çela dhe Dritan Gremi

më të lexuarat

'Rama jepe dorëheqjen!' Tiranë zgjohet me protesta, policia shoqëron 7 protestues

Sekuestrohen 3 automjete luksoze në Vlorë, nis hetimi pasuror ndaj pronarëve

Përplasja me armë/ Alket Rizai në kërkim, sot duhej të paraqitej në burg pasi kishte marrë leje

Si u rrëzua banda shqiptare e trafikantëve nga imazhi i një luani i krijuar me IA

Trafikanti shqiptar i shpëton burgut: Partnerja ka depresion dhe dhimbje kronike

Alarmi për bombë në një shkollë në Tiranë rezulton fals, arrestohet një person/ EMRI



Futi paisje e 'Botox' kontrabandë, 285 mln lekë të pa paguara! Merret i pandehur biznesmeni Dritan Gremi

15:38, 16/09/2026

ZMADHO TEKSTIN



Nga Elton Qyno Syri.net

Një dosje hetimore që bën fjalë për "kontrabandim të medikamenteve mjekësore" dhe "Fshehjen e të ardhurave financiare" është regjistruar në gjykatën e Tiranës, me të pandehur Dritan Gremi dhe shoqërinë Juridike, "Gremi Wellnes".

Çështja penale me emrin e biznesmenit të disa klinikave estetike dhe 11 bizneseve të hapura në Tiranë dhe Elbasan, është publikuar si i pandehur në seancat gjyqësore që gjykata e Tiranës, ka planifikuar të gjykojë në 22 shtator 2026.

Kujtojmë se në muajin Tetor 2025, Dritan Gremi, u shfaq dhe si kandidat i pavarur për të garuar në zgjedhjet për kryetar bashkie në Tiranë, zgjedhje këto që nuk u zhvilluan kurë.

Siç mëson gazetari Elton Qyno, dosja me 2 të pandehur është ende në fazën e shqyrtimit gjyqësor në seancën paraprake dhe gjyqtare e çështjes është caktuar përmes shortit elektronik, Amarilda Sulaj.

Sipas dosjes hetimore, të pandehurit Dritan Gremi dhe shoqëria e tij "Gremi Wellnes" dyshohet se kanë kryer kontrabandë të medikamente mjekësorë, kryesisht "Butox" me princip aktiv "Botulinum toxin".

Ky medikament mjekësor aktualisht nuk është i paisur me autorizim për tregtim në Shqipëri.

Ndërkohë edhe paisjet mjekësore që vendosen në treg në Republikën e Shqipërisë, duhet të regjistrohen në Regjistrin Kombëtar të Paisjeve Mjekësore, procedurë kjo që mbahet nga Agjensia Kombëtare e Barnave dhe Paisjeve Mjekësore.

Në Klinikë janë gjetur paisje mjekësore të paçertifikuara dhe kryheshin injeksione nga persona të cilët nuk janë mjekë por estetiste. Fakt ky i konfirmuar nga disa pacientë që janë pyetur.

Shkeljet janë konstatuar gjatë një kqyrje fizike në ambientet e "Gremi Clinic" që është kryer nga policia gjyqësore në datën 17 korrik 2025.

Gjinashtu, sipas dosjes neuimore po në vitin 2025, gjate një raporti të kontrollit taunior mbi këtë biznes, është konstatuar se shoqëria Juridike, "Gremi Wellnes" ka detyrime tatimore dhe gjoba të papaguara që shkojnë në shumën financiare prej 285 milion lekë të vjetra.

Kjo kompani dhe pronarët e saj, bashkëjetuesit Dritan Gremi dhe Anduena Çela, prej Janarit 2021 kanë operuar si biznes me objekt tregtar fillimisht për "...aktivitete të këshillimit për biznes dhe këshilla të tjera për menaxhimin...".

Por në muajin Nëntor 2025, objekti i kompanisë ndryshoi duke shtuar aktivitetin në fushën e menaxhimit të strukturave të ndryshme në fushën e shëndetësisë

"...kryesisht klinikave të kirurgjisë estetike dhe trajtimeve të tjera estetike, duke marrë përsipër menaxhimin në total të burimeve njerëzore dhe marrëdhënieve me pacientët (çaktimi i orareve të vizitave, të orareve të ekzaminimeve, të trajtimeve estetike dhe kirurgjikale, promovimet dhe ndjekja e politikave për zgjerimin e nr. të pacienteve etj...."-thuhet në objektin e veprimtarisë tregtare të ndryshuar në muajin Nëntor 2025.

Por vetëm pak ditë pasi Dritan Gremi, i ndryshoi objektin e veprimtarisë tregtare kompanisë "Gremi Wellnes", ai në 27 Nëntor 2025, vendosi t'ia shesë 100 për qind të aksioneve të kësaj kompanie, bashkëjetueses së tij, Anduena Çela.

Kontrata e shitjes është firmosur para noteres Aida Hoxha në Tiranë dhe shitja është bërë kundrejt një çmimi prej 1 milion lekë të vjetra.

Por aktualisht në emër të Dritan Gremi, vijojnë të jenë disa kompani të tjera si "Gremi Longevity Center", "My Albania News", "Gremi Sweet Bread", "La Belle Noiseuse", "Hotel Serenity", "Gremi Clinic", "Dritan Gremi", "Viaggiare e Sorridere" e të tjera.

© SYRI.net

Lexo edhe:



VIDEO/ Plagosje me armë zjarri në Durrës



Arkitekti Olsi Eftimi ka dhënë deklaratime në SPAK lidhur me hetimet për dosjen 'Balluku'



Vijojnë kontrollet në burgje, sekuestrohet një tjetër telefon në qelinë e të dënuarit në Durrës

Roskovec/ Daja i Zegjine Çaushtit plagosi me çekiq ish-vjehrrin e tij



Arrestohet në flagrancë një efektiv policie, dy të tjerë hetohen në gjendje të lirë



I dhunojnë dhe arrestojnë/ Policia prangos 12 protestues se thirrën: Rama jepe dorëheqjen

TË NGJASHME



Dosja e AKSHI-t/ Karçanaj dhe 4 të tjerë i kërkojnë Gjykatës së Lartë heqjen e sekuestrove mbi pasuritë



Një ditë pas dënimit nga GJKKO, Aldo Avdyli merr dënim të dytë me 3 vite burgim për pistoletën 'Bereta'



Kapet në makinë me 6 emigrantë nga Sudani, 700 euro 'bileta' për në Tiranë! Arrestohet 23 vjeçari



Vrasja e Kevin Muharremi/ Shtohen telashet ligjore për Renato Xyken, akuzohet edhe për plagosje



Arratisja e radhës e Alket Rizait/ Kishte përfituar 16 leje nga burgu, nis mega-operacioni i kërkimit



Shkatërrohet banda e shqiptarëve, dyshohet për të paktën 40 grabitje në banesa



18 kg drogë, në pranga trafikanti shqiptar në Vjenë

LAJME POLITIKE KRONIKE EKONOMI KOSOVA BOTË KULTURË SHKENCI SPORT JETË/STIL TRASHËGIMI MIEDIS ARKIVA



SYRI.net është agjencia më e madhe e lajmeve në Shqipëri, që brenda një kohe të shkurtër është kthyer në lider të informacionit. Në SYRI.net do të gjeni opinionistë më me emër në vendin tonë, investigime dhe lajme që nuk do ti gjeni diku tjetër. Lajmet në SYRI.net janë prodhim i SYRI.net dhe nuk lejohet marrja e tyre pa një komunikim të mëparshëm me redaksinë. Ju ftojme të klikoni dhe të na shkruani sa herë që ju mendoni se duhet. Stafi i SYRI.net

Për informacione info@syri.net, për reklama marketing@syri.net

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.